

UDHËZIM
Nr.3, datë 18.3.2004

**PËR FORMAT DHE PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT DHE TË RAPORTIMIT NGA
ORGANET, QË LICENCOJNË PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË, NË FUNKSION TË
PROCESIT TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE**

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10/2 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Organet licencuese të kryejnë identifikimin e personave, që kërkojnë të licencohen para dhënies së licencës për të gjitha veprimet, për shuma nga 2 000 000 (dy milionë) lekë, a kundërvlerën e tyre në monedha të tjera, sipas kërkesave të nenit 4 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", të ndryshuar.

Personat fizikë dhe juridikë të identifikohen edhe në rastet kur ka të dhëna ose dyshime të bazuara në fakte e rrethana konkrete për pastrim parash, edhe për vlera financiare nën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Organet licencuese të krijojnë dosje të veçanta dhe të regjistrojnë në to të gjitha të dhënat identifikuese të personave që kërkojnë të licencohen ose që janë licencuar.

Në këtë dosje të përfshihen të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Për personin fizik, jotregtar, individ: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin e përkohshëm a të përhershëm, numrin dhe llojin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe organin që e ka lëshuar atë, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në këto të dhëna, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

b) Për personin juridik: emrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, numrin e lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, selinë e përkohshme a të përhershme, objektin e veprimtarisë tregtare, qëllimin, llojin, datën, shumën dhe monedhën me të cilën kryhet veprimi financiar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

c) Për përfaqësuesin ligjor të klientit që do të licencohet: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, numrin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe lëshuesin e këtij dokumenti, aktin e përfaqësimit (prokurën), si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në këto të dhëna, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

3. Dokumentacioni i identifikimit të të gjithë personave fizikë a juridikë, që do të licencohen, të ruhet për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënieve juridike, civile me ta.

4. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës" për çdo dyshim të bazuar, për burimin ose origjinën e kapitalit, natyrën e veprimit financiar etj., pavarësisht nga vlera e përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar, për parandalimin e pastrimit të parave, në rastet:

a) kur kanë dyshime të bazuara në fakte e rrethana konkrete, që mund të lidhen me parregullsi në dokumentacionin identifikues dhe justifikues të burimit të ligjshëm të kapitaleve me ato reale;

b) kur vërejnë parregullsi në deklarimin e burimeve të të ardhurave ose të kapitaleve, si dhe kur dyshojnë për burimet e pasurisë ose të parave të deklaruar a lidhje me veprimtari penale;

c) kur vërejnë mosjustifikim të pasurisë a të parave të deklaruar nga pikëpamja ekonomike apo ligjore;

ç) kur ka informacione, sinjalizime a të dhëna se paratë ose pasuritë e depozituara për licencimin rrjedhin nga vepra penale ose janë të përziera me para ose pasuri të tilla apo kur dyshojnë se veprimtaria, për të cilën kërkohet të licencohen, do të ngrihet për të realizuar ose mbështetur pastrimin e parave etj.;

d) kur vërejnë mosdeklarim të burimit të kapitalit ose të të ardhurave;

e) kur kanë dyshime të tjera, të bazuara në gjendjen ose rrethanat, të cilat nuk janë parashikuar më lart.

Për çdo rast dyshimi, raportimi të bëhet sipas aneksit 1 "Formulari i sinjalizimit për persona që licencohen", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

5. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës" për personat që paraqesin kërkesën për licencim, përpara dhënies së licencës për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, për çdo veprim financiar mbi 20 000 000 (njëzet milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera, sipas aneksit 2 "Formulari i veprimeve financiare për personat fizikë dhe juridikë, që licencohen", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

6. Organet licencuese të kërkojnë deklarin e burimit të ligjshëm të kapitaleve dhe sqarime të mëtijshme për paqartësi rreth identifikimit të personit fizik ose juridik, administratorit, ortakëve dhe burimeve, si dhe të bëjnë verifikime për kapitalin fillestar të personave fizikë a juridikë, për të qartësuar burimin e krijimit të këtij kapitali për ushtrimin e veprimtarisë.

7. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës", menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për të gjitha rastet e parashikuara më sipër, si dhe për çdo të dhënë tjetër, që vërteton ose kundërshton, të dhënat e bazuara në fakte ose rrethana konkrete a dyshime për pastrim parash, me faks, e-mail, telefon, korrier, duke e shoqëruar me një raport zyrtar, me shkrim.

8. Organet licencuese të njoftojnë "autoritetin përgjegjës" në të njëjtën mënyrë, në çdo rast kur kanë të dhëna ose dyshime për implikime ose qëllime, që veprimtaria do të përdoret për të mbështetur, lehtësuar, ruajtur, nxitur ose fshehur akte terroriste apo do të financojë terrorizmin.

9. Organet licencuese të caktojnë një drejtues të nivelit të lartë, tek i cili nëpunësit dhe punonjësit, që merren me procesin e licencimit, të raportojnë të dhëna të mjaftueshme, që mund të shërbejnë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 5 të ligjit, për parandalimin e pastrimit të parave.

10. Organet licencuese të sigurojnë krijimin e një qendre për grumbullin e të dhënave për parandalimin e pastrimit të parave, sipas detyrimit të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000.

11. Organet licencuese të hartojnë programe kontrolli për testimin e sistemit dhe të bashkëpunojnë me organet e kontrollit të brendshëm të institucionit, për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

12. Organet licencuese t'i dërgojnë "autoritetit përgjegjës", në afatet e përcaktuara, të dhënat shitesë dhe dokumentet e kërkuara. Kur ka arsye të bazuara se afati i caktuar është i pamjaftueshëm, kërkohet zgjatja e tij, por jo më shumë se 15 ditë nga marrja e kërkesës.

13. Në përputhje me detyrimet përkatëse ligjore dhe sipas fushës së veprimtarisë, organet licencuese të përgatisin dhe të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme, për të vlerësuar dhe identifikuar transaksionet e lidhura me veprimtari të paligjshme.

14. Organet licencuese të marrin masat përkatëse për të njoftuar në mënyrë periodike, punonjësit, për procedurat ligjore të veprës penale të pastrimit të parave, si dhe për hartimin e programeve të trajnimit dhe të kualifikimit të personelit.

15. Organet licencuese, që përcaktohen në nenin 10/2 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar dhe punonjësit e drejtuesit e çdo niveli, që ngarkohen me raportimin e transaksioneve të dyshimta, në zbatim të nenit 6 të ligjit, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe ndalohen të njoftojnë subjektet që do të licencohen, për procedurat e verifikimit, dyshimet dhe për çdo të dhënë tjetër për pastrimin e parave.

16. Organet licencuese detyrohen t'i mbajnë dhe t'i ruajnë raportimet për veprimin financiar të subjektit që do të licencohet, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit financiar.

17. Organet licencuese, në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar, janë të detyruara të zbatojnë urdhrat e "autoritetit përgjegjës" për bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit a të veprimit financiar, për një periudhë jo më tepër se 72 orë, në rastet e licencimit, kur subjekti që licencohet kryen pagesën e kapitalit themeltar ose shtimin e kapitalit.

18. Ngarkohen "autoriteti përgjegjës", organet që licencojnë personat fizikë dhe juridikë dhe institucionet nga të cilat varen këto organe për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano